- (b) Ne *[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]*, nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës *[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]*.
- (c) Ne ofrojmë të kryejmë për Autoritetin/Entin Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Shërbimet për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Artikujve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.
- (d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme::
 - 1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
 - 2. Njoftimin e Kontratës;
 - 3. Kriteret e Përzgjedhjes;
 - 4. Specifikimet teknike, grafikun e ekzekutimit dhe termat e referencës;
 - 5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
 - 6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
 - 8. Listat e Çmimeve të Shërbimeve.
- (e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**
- (f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 2.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

LISTA E ÇMIMEVE TË SHËRBIMEVE

Data: _____

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE): _____

Monedha: _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, këto do të rregullohen në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë artikujt në Formularin e Shërbimeve dhe grafikut të ekzekutimit duhet të hidhen dhe tu vendoset çmimi i ofruar në Listën përkatëse të Çmimeve për shërbimet. Shërbimetpa çmim do të konsiderohen si shërbime të paofruar dhe do të cojnë në refuzimin e ofertës.

Lista e Çmimeve

<i>1</i>	<i>2</i>	<i>3</i>	<i>4</i>	<i>6</i>	
Artikulli	Përshkrimi i shërbimit	Sasia	çmimi për njësi	Çmimi total për shërbim (3 x 4X)	
1.					
2.					
3.					
4					
	Çmimi total (Mallrat)				_____
Çmimi Neto pa TVSH					
TVSH (%)					
Çmimi total me TVSH:					
Emri i përfaqësuesit të ofertuesit					
Nënshkrimi					

Vula	
Datë _____	

Shtojca 3.

[Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor]

Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

* * *

Procedura e prokurimit [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-se

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit/entit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës se prokurimit kur autoriteti/enti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës].

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

Shtojca 4.

(Shtojcë për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti/Enti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfaqësuesi i Ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 5.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Specifikimet Teknike të shërbimeve objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Kompania "Albpetrol" Sh.a., ka nën administrimin e saj disa vendburime naftë. Vendburimet që paraqesin sfida të konsiderueshme në fushën e remontit nëntokësor janë vendburimi Amonicë i Qendrës së Prodhimit të Naftës Gorisht, vendburimi Cakran-Mollaj i Qendrës së Prodhimit të Naftës Fier dhe vendburimi Kuçovë i Qendrës së Prodhimit të naftës Kuçovë. Këto sfida vijnë si pasojë e disa faktorëve:

- **Karakteristikat e këtyre vendburimeve.** Këto vendburime kanë presionet në grykë të pusit që shkojnë mbi 150 Atm dhe puset kanë nevojë për pajisje teknologjike të hermetizimit të grykave (Preventor B.O.P) përveç vendburimit Kuçovë.
- **Karakteristikate puseve dhe teknologjia e shfrytëzimit.** Thellësia në disa puse të këtyre vendburimeve shkon në mbi 2000m dhe disa puse janë në shfrytëzim me teknologjinë jet-Pump. Vetëm procedura e shpakerimit (Ç'kunjasja e packerit nga fundi i pusit) mund të kërkojë aftësi tërheqëse mbi 50 Ton.

Duke patus parasysh se puset që kërkojnë këto shërbime janë puse me prodhim të konsiderueshëm (Ca-34, Ca-57, Ca-62, Mo-39, Mo-40, Fe-52 etj.) dhe puse injektimi që mund të ndalojnë komplet vendburimet në rast bllokimi (Am-44, Go-29, Ca-32, Po-7 etj.) atëherë lind nevoja që këto puse të mbahen në gjendje pune me çdo mënyrë.

Autosondat që ka në inventar shoqëria "Albpetrol" Sh.a dhe që aktualisht kryejnë shërbime remonti në puse, kanë kapacitete të reduktuar ngritëse (deri në 20 ton) kryesisht për puse të cekët. Gjithashtu ato nuk janë të pajisura me mjete hermetizuese të grykës së pusit.

Si rezultat shërbimet e remontit nëntokësor në një pjesë të puseve të Qendrës së Prodhimit të Naftës Gorisht, Qendrës së Prodhimit të Naftës Fier dhe Qendrës së Prodhimit të naftës Kuçovë do të kryhen me autosonda me kullë me të tretë.

Referuar Pogramit të Zhvillimit Ekonomik 2024 të shoqërisë "Albpetrol" Sh.a, për të plotësuar nevojat e remontit nëntokësor në puset ku kompania nuk mund të ndërhyjë me mjetet e saj, nevojiten 800 orë pune (Shërbime me autosondë \geq 70 Ton).

I. Përshkrimi i Përgjithshëm.

Autosonda e remontit nëntokësor është një agregat shumë kompleks që është integruar mbi një kamion special në të cilin janë instaluar nëpërmjet një shasie të dubluar të gjitha pajisjet e autosondës së remontit.

Konstruktimi i këtij agregati (Autosonda) konsiston në shfrytëzimin maksimal të rendimentit të fuqisë motorrike të kamionit special nëpërmjet sistemit të transmesioneve, freksionit të fuqisë, kamios , kutisë hidraulike të konvertimit të fuqisë, arganellos dhe sistemit të saj të frenimit, kutisë së shpejtësisë të arganellos, kullën teleskopike me dy seksione, sistemin e matjes së peshave ngritëse, sistemin elektrik, sistemin hidraulik për lidhjen e kyçeve hidraulike, sistemin e makarasë të nderlidhur me cipllakun + parangon dhe litarin e çelikut që mbështillet në arganello, kompletojnë kështu një makineri të garantuar për ngritjen dhe uljen e tubove dhe purtekave në pusët e naftës dhe te gazit.

Përdorimi i kësaj pajisje në pusët e kompanisë vjen si rezultat i amortizimit të kullave të puseve ku shumica e tyre janë rrëzuar në mënyrë të kontrolluar sepse nuk plotësonin më kushtet e teknike për punën normale dhe nuk garantonin dot sigurinë e personelit të brigadave të remontit nëntokësor që punonin në puse.

Për këtë arsye autosondën me kullë me goma që do të punojë në këto vendburime duhet të plotësojnë specifikimet teknike si më poshtë:

II. Specifiket Teknike dhe termat e referencës për pompën autosondën.

a) Autosonda 70 Ton.

- Duhet të ketë kapacitet ngritës ≥ 70 ton (700 kN) .
- Duhet të jetë e pajisur me kullë dhe lëvizja e saj (Në mënyrë direkte apo indirekte) të bëhet nëpërmjet gomave.
- Duhet të jetë sondë e dyfishtë për punime.
 - i. Dizajni:
 - Sonda e dyfishtë për punime duhet të ketë dy tamburë ose mbështjellës që i lejojnë të trajtojnë operacione më komplekse në të njëjtën kohë.
 - Më i madh dhe më i fuqishëm se sonde njëfishtë, me mbështetje dhe stabilitet të përmirësuar strukturor.
 - ii. Kapacitetet:
 - Kompleksiteti: I përshtatshëm për operacione më komplekse dhe të rënda. Me dy tamburë që lejojnë kontroll më të madh dhe aftësinë për të kryer detyra të njëkohshme, si p.sh. futja dhe tërheqja e vargjeve të shumta ose trajtimi i pajisjeve më të mëdha dhe më të rënda.
 - Kapaciteti i Ngarkesës: Kapaciteti më i lartë i ngarkesës krahasuar me një sonde njëfishtë, duke e mundur të menaxhojë punime më kërkuese, përfshirë pusët më të thella ose diametrat më të mëdhenj të tubave.
 - Operacionet: Mund të përdoret për punime më intensive, përfshirë përfundimet me vargje të dyfishta, ndërhyrje në puse më të thella, punime më të ndërlikuara të nxjerrjes (fishing) dhe punime të rënda riparuese.
- Duhet të jetë e pajisur sistem ajri për hapjen dhe mbylljen e kunjave pneumatike (Slips) mbështetëse të tubove.
 - Duhet të jetë e pajisur me sistem hidraulik. Panel hidraulik komande për hapje-mbyllje të sistemit të preventorëve (BOP, Anular BOP). Me dalje për lidhjen e kyçeve hidraulike dhe rrotorit hidraulik.
 - Duhet të jetë e pajisur me vinç hidraulik për ngritje pajisje me kapacitet ≥ 2.5 ton.
 - Duhet të jetë e pajisur me sistemin e fikjes të emergjencës.
 - Sistemi i shkarkimit të gazrave duhet të jetë e pajisur me parandalues shkëndije për mbrojtjen nga shpërthimi i zjarrit.

- Sonda duhet të ketë me vete platformën e punës për punëtorët dhe skelë për tubot dhe pajisjet që ndodhen në sheshin e pusit .
 - Sonda duhet të jetë e pajisur me tester i kompletuar me tubo gomë të presionit të lartë ≥ 3000 psi, i cili të realizojë qarkullimin për pastrimin e pusit përgjatë operacioneve të ndryshme të remontit.
 - Sonda duhet të jetë e pajisur me rrotullues hidraulik (Rrotor), me qëllim për të siguruar momentin rrotullues të instrumentit të remontit nëntokësor për frezime në trungun e pusit.
 - Duhet të jetë e shoqëruar me pompë presioni ≥ 200 atm dhe debit ≥ 40 m³/orë, e cila të realizojë qarkullim e fluidit në trungun e pusit, për mbytjen, larjen e pusit ose frezime në trungun e pusit.
 - Duhet të ketë me vete kabinë me material të lehtë në shesh të pusit për punëtorët dhe supervizorin e Albpetrol.
 - Duhet të jetë e pajisur me elevatore për tubing nga 2-3/8" deri në 3-1/2", (Të gjitha llojet e elevatoreve për të gjitha llojet dhe dimensionet e tubove).
 - Duhet të jetë e pajisur me elevator për purteka nga 3/4" deri në 1-1/4", (Të gjitha llojet e elevatoreve për të gjitha dimensionet e purtekave).
 - Duhet të jetë e pajisur me kyçe hidraulike për tubing nga 2-3/8" deri në 3-1/2", (Të gjitha llojet e kyçeve për të gjitha llojet dhe dimensionet e tubove).
 - Duhet të jetë e pajisur me kyçe hidraulike për purteka nga 3/4" deri në 1-1/4", (Të gjitha llojet e kyçeve për të gjitha dimensionet e purtekave).
 - Duhet të jetë e pajisur me peshkatore për tubing nga 2-3/8" deri në 3-1/2", (Të gjitha llojet e peshkatoreve për të gjitha llojet dhe dimensionet e tubove).
 - Duhet të jetë e pajisur me peshkatore për purteka nga 3/4" deri në 1-1/4", (Të gjitha llojet e peshkatoreve për të gjitha dimensionet e purtekave).
 - Duhet të jetë e pajisur me pajisje fshirëse për tubing nga 2-3/8" deri në 3-1/2", (Të gjitha llojet e fshirëseve për të gjitha llojet dhe dimensionet e tubove).
 - Duhet të jetë e pajisur me pajisje fshirëse për purteka nga 3/4" deri në 1-1/4", (Të gjitha llojet e fshirëseve për të gjitha dimensionet e purtekave).
 - Duhet të jetë e pajisur sistem kunjash pneumatike (Slips) mbështetëse për tubing nga 2-3/8" në 3-1/2", (Të gjitha llojet e kunjave për të gjitha llojet dhe dimensionet e tubove).
 - Duhet të jetë e pajisur me stampa të të gjitha dimensioneve për marrjen e gjurmëve të purtekave brenda tubove me dimensione nga 2-3/8" deri në 8-5/8" dhe për marrjen e gjurmëve të tubove brenda kollonave të shfrytëzimit me dimesione nga 5-1/2" në 8-5/8".
 - Duhet të jetë e pajisur me olivo të të gjitha dimensioneve, për punime në kollona me dimesione nga 5" deri në 8-5/8".
 - Duhet të jetë e pajisur me gërryerëse të të gjitha dimensioneve, për punime në kollona me dimesione nga 5" deri në 8-5/8".
 - Duhet të jetë e pajisur me preventore (B.O.P):
- Preventor dy shkallësh për tubo me mbyllje unazore dhe qorre për presion ≥ 5000 psi preventori duhet të përputhet me fillanxhë mbështetëse 7-1/16" (5000 psi, 7000 psi dhe 10000 psi) dhe të sigurojë mbyllje unazore për tubo nga 2-3/8" deri më 3-1/2" .
 - Preventor për purteka me presion ≥ 3000 psi .
 - Duhet të jetë e pajisur me fikëse zjarri 14 kg ABC.
 - Duhet të jetë e pajisur me kutinë e ndihmës së shpejtë.
 - Duhet të jetë e pajisur me detektor gazi H₂S.
 - Duhet të jetë e pajisur me pajisje speciale kundërgazi, aparat frymëmarrje të kompletuar me bombola oksigjeni.
 - Duhet të jetë e pajisur me rrip sigurimi për ngjitjet në lartësi.
 - Duhet të jetë e pajisur me urë për sistemimin e tubove dhe purtekave për minimalisht 3000 metër linear tubing 2-7/8" TS.

b) **Specifikimet për personelin;**

- Një brigadë remonti duhet të jetë e kompletuar gjatë punës me: Brigadier, Manovrator, dy Përgjegjës Kyçi, dy Përgjegjës Fushe.
- Brigada e punës që do të kryejë operacionet hidrokarbure me autosondë duhet të jetë e përbërë nga: Manovratori, përgjegjësit e kyçit (Punonjësit e bazës), punjonjësit e fushës, brigadieri dhe drejtuesi teknik i punimeve i cili duhet të jetë inxhinier naftë, dhe të jetë i pajisur me Certifikatën e Lejes Profesionale.
- Brigada e remontit duhet të jetë me eksperiencë jo më pak se 3 vjet në punimet e remontit nëntokësor të kërkuar nga Albpetrol Sh.a në këtë dokument.
- Sonda së bashku me brigadën do të punojë jo më shumë se 12 orë në ditë dhe në asnjë rast natën.
- Kontraktori do të marrë masa të respektojë kodin e punës qoftë përsa i përket orarit të punës qoftë përsa i përket respektimit të rregullave të sigurimit teknik dhe sigurisë në punë.
- Kontraktori duhet të sigurojë uniformën dhe pajisjet mbrojtëse në punë për personelin e tij.
- Kontraktori duhet të verë në dijeni me shkrim Drejtorinë e Prodhimit të kompanisë Albpetrol Sh.a të paktën 1(një) javë më parë përsa i përket punimeve periodike për mirëmbajtjen e mjetit.

c) **Kontraktori ka për detyrë dhe plotësoj kushtet si më poshtë (Termet e references);**

- Kryerjen e Proceseve të Operacioneve Hidrokarbure në pusët e fondit të ndalur dhe pusët aktive në vendburimet gëlqerore të naftës të kompanisë Albpetrol Sh.a, të cilët për arsye të ndryshme kanë ndërprerë prodhimin e naftës. Punimet do të kryhen në zbatim të programeve të punës të hartuar nga Qendra e Prodhimit të Naftës përkatëse dhe të miratuar nga Drejtoria e Prodhimit dhe Drejtoria e Gjeologjisë & Studimit për ç'do pus të veçantë, për rivënien e tij në shfrytëzim.
- Kontraktori duhet të caktojë një person kontakti i cili në bashkëpunim me komisionin e mbikqyrjes së punimeve të ngritur nga QPN përkatëse duhet që:
 - Planifikojë dhe zërtheje programin e remontit së bashku me komisionin e mbikqyrjes së punimeve të ngritur nga Q.P.N përkatëse dhe Supervizorin e ndjekjes së ecurisë së kontratës emëruar nga Albpetrol Sh.a.
 - Të referojë kërkesat për materiale dhe mjete që nuk janë pjesë e sondës të komisioni për mbikqyrjen e punimeve të Q.P.N përkatëse në kohën e duhur.
 - Është përgjegjës për sigurimin e punimeve me mjetet e sondës dhe të sigurohet që të ndiqen procedurat e punës për parandalimin e aksidenteve në punë.
 - Të sigurojë ç'do relacion ose raport që kërkohet nga komisioni i mbikqyrjes së punimeve të QPN ku ushtrohet aktiviteti.
 - Të dorëzojë të komisioni i mbikqyrjes së punimeve të QPN raportin ditor të punimeve të kryera në puse.
 - Të dorëzojë të komisioni i mbikqyrjes së punimeve të QPN një inventar të hollësishëm për të gjitha mjetet dhe pajisjet në shesh të pusit një herë në javë.
 - Të dorëzojë të komisioni i mbikqyrjes së punimeve të QPN raportin e përfundimit të punimeve për ç'do remont sapo ai ka përfunduar.
- Kontraktuesi menjëherë pas nënshkrimit të kontratës do të fillojë punën për kryerjen e shërbimit në pusët e fondit të ndalur dhe pusët aktive në vendburimin e naftës Cakran-Mollaj të Q.P.N, në vendburimin Amonicë të Q.P.N Gorisht dhe në vendburimin Kuçovë të Q.P.N Kuçovë.
- Për pusët në të cilët kontraktori do të kryejë operacione hidrokarbur, do të njoftohet me shkrim nga Qendra përkatëse ku kryen shërbimin (Akti i dorëzimit të sheshit të pusit). Urdhëri nga qendra do të lëshohet mbi bazën e një programi pune hartuar po nga vetë Qendra e Prodhimit dhe miratuar nga Drejtoria e Prodhimit dhe Drejtoria e Gjeologjisë & Studimit.
- Kontraktori do të kryejë procese dhe operacione në puse edhe në rastet kur nuk janë parashikuar në programet e punës të pusit dhe ato dalin si procese të paparashikuara. Këto operacione do të kryhen në bazë të një urdhëri të dhënë nga qendra ku kryhet shërbimi bazuar në një program pune shtesë

hartuar po nga vetë Qendra e Prodhimit dhe miratuar nga Drejtoria e Prodhimit dhe Drejtoria e Gjeologjisë & Studimit.

- Për ç'do pus ku kontraktori do të kryje shërbimin të gjitha pajisjet nëntokësore dhe ato sipërfaqesore si dhe linja elektrike dhe të tjera do të sigurohen nga Qendra përkatëse ku kryhet shërbimi, po ashtu dhe Qendra do të pajisë pusin me grykë të rregullt.
- Vlerësimi i shërbimit të kryer në remontin e puseve do të bëhet me orë pune nga komisioni i mbikqyrjes së punimeve të Q.P.N-ve përkatëse sipas preventivit të proceseve të punës.
- Koha e punës për lëvizjen e sondës nuk do të njihet në orët e punës së shërbimit të remontit.
- Kontraktori për ç'do proces pune që do të kryejë duhet domosdoshmërisht ta evidentojë atë në dokumentacion teknik të rregullt. Në përfundim të ç'do punimi duhet të paraqesë dokumentacionin:
 - **Kopje të programit të punës** të përpiluar nga Qendra e Prodhimit përkatëse dhe miratuar nga Drejtoria e Prodhimit dhe Drejtoria e Gjeologjisë & Studimit. Këtu përfshihen dhe programet e hartuar nga Qendra përkatëse për punimet shtesë dhe miratuar nga Drejtoria e Prodhimit dhe Drejtoria e Gjeologjisë & Studimit.
 - **Urdhër pune me shkrim** (Urdhër i dorëzimit të sheshit të pusit) lëshuar nga Qendra përkatëse ku do të kryhen punimet. Ky dokument duhet të plotësohet me bojë të freskët (Jo fotokopje).
 - **Lista e kontrollit të sondës së shërbimit** plotësohet vetëm një herë në fillim të punimeve. Duhet të jetë i firmosur nga minimumi 1 pjestar i komisionit të mbikqyrjes të punimeve të Qendrës përkatëse. Ky dokument duhet të plotësohet me bojë të freskët (Jo fotokopje).
 - **Deklarata e sigurisë në sheshin e pusit** është një dokument që plotësohet dhe firmoset nga kushdo që hyn në sheshin e pusit për herë të parë. Ky dokument duhet të plotësohet me bojë të freskët (Jo fotokopje).
 - **Takimi paraprak i sigurisë për punë dhe vlerësimi i rrezikut** plotësohet për ç'do ditë që brigada e remontit punon në pus. Duhet të jetë i firmosur nga minimumi 1 pjestar i komisionit të mbikqyrjes të punimeve të Qendrës përkatëse ose supervizori i ndjekjes së ecurisë së kontratës. Ky dokument duhet të plotësohet me bojë të freskët (Jo fotokopje).
 - **Raport pune** (Ditari i punimeve) plotësohet për ç'do ditë që brigada e remontit punon në pus. Këtu shënohet e gjithë ecuria e punimeve gjatë ditës. Duhet të jetë i firmosur nga minimumi 1 pjestar i komisionit të mbikqyrjes të punimeve të Qendrës përkatëse. Ky dokument duhet të plotësohet me bojë të freskët (Jo fotokopje).
 - **Kartelat e matjes së tubove e purtekave**. Ky dokument duhet të plotësohet me bojë të freskët (Jo fotokopje).
 - **Libreza e masave**. Ky dokument duhet të plotësohet me bojë të freskët (Jo fotokopje).
 - Kontraktori gjatë kohës së zbatimit të kontratës mund të zëvendesojë sondën e remontit për arsye defekti ose shërbimi i detyrueshëm me një sondë tjetër me të njëjta karakteristika ose më të mira.
 - Urdhëri i Punës, mbikqyrja, kolaudimi dhe marrja në dorëzim e punimeve të kryera nga subjekti privat, do të bëhet nga komisioni i ngritur nga ç'do Qendër ku kjo autosondë kryen punime, të përbërë nga minimalisht Krye Inxhinieri i Qendrës, Krye Gjeologu i Qendrës dhe një inxhinier naftë me eksperiencë në fushën e remontit nëntokësor për pusët ku kryhet shërbimi.
 - Likuidimi i Kontraktorit do të bëhet vetëm në bazë të situacionit faktik të mbajtur për ç'do pus të secilës Qendër sipas tarifës orare, të konfirmuar nga komisioni përkatës i mbikqyrjes të punimeve dhe miratuar nga Supervizori i kontratës caktuar nga Albpetrol Sh.a.
 - Likuidimi i Kontraktorit nuk do të bëhet në rastet kur pusi nuk vihet në shfrytëzim për arsye të cilesisë së dobët të punimeve të kryera nga ai dhe të konfirmuara nga Supervizori i kontratës dhe komisioni i mbikqyrjes së punimeve të Qendra përkatëse.

Për autosondën si dhe për pajisjet shoqëruese të saj duhet të paraqiten çertifikatat e inspektimit (testimit) nga fabrika prodhuese. Çertifikatat duhet të jenë në standartit API , ISO ose çdo standart i barazvlefshëm përfshirë standartet Shqiptare.

Shtojca 6

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti/enti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT

Shërbimet që kërkohen që kërkohen: Shërbime per punime me autosonde, ne total 800 ore pune.

Afatet e ekzekutimit: Ky shërbim do te kryhet me afat 12 muaj nga data e nënshkrimit te kontrates, ne perputhje me specifikimet teknike dhe termat e references.

Shërbimet	Përshkrimi	Shuma	Vendi i ekzekutimit	Afati i ekzekutimit

Shtojca 7

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

FORMULARI I TERMAVE TË REFERENCËS

Kontraktori ka për detyrë dhe plotësoj kushtet si më poshtë (Termet e references):

- Kryerjen e Proceseve të Operacioneve Hidrokarbure në pusët e fondit të ndalur dhe pusët aktive në vendburimet gëlqerore të naftës të kompanisë Albpetrol Sh.a, të cilët për arsye të ndryshme kanë ndërprerë prodhimin e naftës. Punimet do të kryhen në zbatim të programeve të punës të hartuar nga Qendra e Prodhimit të Naftës përkatëse dhe të miratuar nga Drejtoria e Prodhimit dhe Drejtoria e Gjeologjisë & Studimit për ç'do pus të veçantë, për rivënien e tij në shfrytëzim.
- Kontraktori duhet të caktojë një person kontakti i cili në bashkëpunim me komisionin e mbikqyrjes së punimeve të ngritur nga QPN përkatëse duhet që:
 - Planifikojë dhe zbërtheje programin e remontit së bashku me komisionin e mbikqyrjes së punimeve të ngritur nga Q.P.N përkatëse dhe Supervizorin e ndjekjes së ecurisë së kontratës emëruar nga Albpetrol Sh.a.
 - Të referojë kërkesat për materiale dhe mjete që nuk janë pjesë e sondës të komisioni për mbikqyrjen e punimeve të Q.P.N përkatëse në kohën e duhur.
 - Është përgjegjës për sigurimin e punimeve me mjetet e sondës dhe të sigurohet që të ndiqen procedurat e punës për parandalimin e aksidenteve në punë.
 - Të sigurojë ç'do relacion ose raport që kërkohet nga komisioni i mbikqyrjes së punimeve të QPN ku ushtrohet aktiviteti.
 - Të dorëzojë të komisioni i mbikqyrjes së punimeve të QPN raportin ditor të punimeve të kryera në puse.
 - Të dorëzojë të komisioni i mbikqyrjes së punimeve të QPN një inventar të hollësishëm për të gjitha mjetet dhe pajisjet në shesh të pusit një herë në javë.
 - Të dorëzojë të komisioni i mbikqyrjes së punimeve të QPN raportin e përfundimit të punimeve për ç'do remont sapo ai ka përfunduar.
- Kontraktuesi menjëherë pas nënshkrimit të kontratës do të fillojë punën për kryerjen e shërbimit në pusët e fondit të ndalur dhe pusët aktive në vendburimin e naftës Cakran-Mollaj të Q.P.N, në vendburimin Amonicë të Q.P.N Gorisht dhe në vendburimin Kuçovë të Q.P.N Kuçovë.
- Për pusët në të cilët kontraktori do të kryejë operacione hidrokarbur, do të njoftohet me shkrim nga Qendra përkatëse ku kryen shërbimin (Akti i dorëzimit të sheshit të pusit). Urdhëri nga qendra do të lëshohet mbi bazën e një programi pune hartuar po nga vetë Qendra e Prodhimit dhe miratuar nga Drejtoria e Prodhimit dhe Drejtoria e Gjeologjisë & Studimit.
- Kontraktori do të kryejë procese dhe operacione në puse edhe në rastet kur nuk janë parashikuar në programet e punës të pusit dhe ato dalin si procese të paparashikuara. Këto operacione do të kryhen në bazë të një urdhëri të dhënë nga qendra ku kryhet shërbimi bazuar në një program pune shtesë hartuar po nga vetë Qendra e Prodhimit dhe miratuar nga Drejtoria e Prodhimit dhe Drejtoria e Gjeologjisë & Studimit.
- Për ç'do pus ku kontraktori do të kryejë shërbimin të gjitha pajisjet nëntokësore dhe ato sipërfaqesore si dhe linja elektrike dhe të tjera do të sigurohen nga Qendra përkatëse ku kryhet shërbimi, po ashtu dhe Qendra do të pajisë pusin me grykë të rregullt.
- Vlerësimi i shërbimit të kryer në remontin e puseve do të bëhet me orë pune nga komisioni i mbikqyrjes së punimeve të Q.P.N-ve përkatëse sipas preventivit të proceseve të punës.
- Koha e punës për lëvizjen e sondës nuk do të njihet në orët e punës së shërbimit të remontit.
- Kontraktori për ç'do proces pune që do të kryejë duhet domosdoshmërisht ta evidentojë atë në dokumentacion teknik të rregullt. Në përfundim të ç'do punimi duhet të paraqesë dokumentacionin:
 - **Kopje të programit të punës** të përpiluar nga Qendra e Prodhimit përkatëse dhe miratuar nga Drejtoria e Prodhimit dhe Drejtoria e Gjeologjisë & Studimit. Këtu përfshihen dhe programet e

hartuar nga Qendra përkatëse për punimet shtesë dhe miratuar nga Drejtoria e Prodhimit dhe Drejtoria e Gjeologjisë & Studimit.

- **Urdhër pune me shkrim** (Urdhër i dorëzimit të sheshit të pusit) lëshuar nga Qendra përkatëse ku do të kryhen punimet. Ky dokument duhet të plotësohet me bojë të freskët (Jo fotokopje).
- **Lista e kontrollit të sondës së shërbimit** plotësohet vetëm një herë në fillim të punimeve. Duhet të jetë i firmosur nga minimumi 1 pjestar i komisionit të mbikqyrjes të punimeve të Qendrës përkatëse. Ky dokument duhet të plotësohet me bojë të freskët (Jo fotokopje).
- **Deklarata e sigurisë në sheshin e pusit** është një dokument që plotësohet dhe firmoset nga kushdo që hyn në sheshin e pusit për herë të parë. Ky dokument duhet të plotësohet me bojë të freskët (Jo fotokopje).
- **Takimi paraprak i sigurisë për punë dhe vlerësimi i rrezikut** plotësohet për ç'do ditë që brigada e remontit punon në pus. Duhet të jetë i firmosur nga minimumi 1 pjestar i komisionit të mbikqyrjes të punimeve të Qendrës përkatëse ose supervizori i ndjekjes së ecurisë së kontratës. Ky dokument duhet të plotësohet me bojë të freskët (Jo fotokopje).
- **Raport pune** (Ditari i punimeve) plotësohet për ç'do ditë që brigada e remontit punon në pus. Këtu shënohet e gjithë ecuria e punimeve gjatë ditës. Duhet të jetë i firmosur nga minimumi 1 pjestar i komisionit të mbikqyrjes të punimeve të Qendrës përkatëse. Ky dokument duhet të plotësohet me bojë të freskët (Jo fotokopje).
- **Kartelat e matjes së tubove e purtekave.** Ky dokument duhet të plotësohet me bojë të freskët (Jo fotokopje).
- **Libreza e masave.** Ky dokument duhet të plotësohet me bojë të freskët (Jo fotokopje).
 - Kontraktori gjatë kohës së zbatimit të kontratës mund të zëvendësojë sondën e remontit për arsye defekti ose shërbimi i detyrueshëm me një sondë tjetër me të njëjta karakteristika ose më të mira.
 - Urdhëri i Punës, mbikqyrja, kolaudimi dhe marrja në dorëzim e punimeve të kryera nga subjekti privat, do të bëhet nga komisioni i ngritur nga ç'do Qendër ku kjo autosondë kryen punime, të përbërë nga minimalisht Krye Inxhinieri i Qendrës, Krye Gjeologu i Qendrës dhe një inxhinier naftë me eksperiencë në fushën e remontit nentokësor për pusët ku kryhet shërbimi.
 - Likujdimi i Kontraktorit do të bëhet vetëm në bazë të situacionit faktik të mbajtur për ç'do pus të secilës Qendër sipas tarifës orare, të konfirmuar nga komisioni përkatës i mbikqyrjes të punimeve dhe miratuar nga Supervizori i kontratës caktuar nga Albpetrol Sh.a.
 - Likujdimi i Kontraktorit nuk do të bëhet në rastet kur pusi nuk vihet në shfrytëzim për arsye të cilesisë së dobët të punimeve të kryera nga ai dhe të konfirmuara nga Supervizori i kontratës dhe komisioni i mbikqyrjes së punimeve të Qendra përkatëse.

Për autosondën si dhe për pajisjet shoqëruese të saj duhet të paraqiten certifikatat e inspektimit (testimit) nga fabrika prodhuese. Certifikatat duhet të jenë në standartit API , ISO ose çdo standart i barazvlefshëm përfshirë standartet Shqiptare.

Shtojca 8

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale;
- dh) nuk ka pagesa të pushlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 9.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti/EntiKontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

- Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.

- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.1.1. Kapaciteti ligjor plotësohet duke dorëzuar dokumentat sipas Kriteve të përgjithshme të pranimit/ kualifikimit.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Kopje të certifikuar të bilancit për vitet financiare 2021, 2022, 2023, të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të ligjit nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit, të konfirmuar nga administrata tatimore.

2.2.2. Vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2021, 2022, 2023, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit

2.3 Kapaciteti teknik:

2.2.1. Shërbime të mëparshme të ngjashme në një vlerë jo më të vogël se: 40 % e fondit limit objekt prokurimi, të realizuara gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës;

Si deshmi per pervojen e meparshme kerkohen te paraqiten:

Vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

OSE

Ne rastin e pervojes se meparshme te realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të shërbimeve të furnizuara.

2.3.1. Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur me çertifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit i vendit ku është akredituar ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit në Shqipëri (DPA). Çertifikatat që kërkojnë duhet të jenë e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit:

Operatori/et ekonomik duhet të paraqes/in Certifikata ISO ose ekuivalente dhe duhet të jenë në përputhje me objektin e prokurimit:

- ISO 9001:2015 (ose ekuivalente)
- OHSAS 18001-2007 ose ISO 45001-2018 (ose ekuivalente)
- ISO 14001-2015 (ose ekuivalente)

2.3.2. Operatori ekonomik ofertues te paraqese nje deklarate nepermjet se ciles garanton se ai eshte i afte dhe merr persiper kryerjen e te gjitha proceseve te punes te kerkuara nga AK me cilesi dhe profesionalizem, sipas specifikimeve teknike, termave te references dhe programeve te punes.

2.3.3. Operatori ekonomik ofertues te paraqese nje deklarate nepermjet se ciles garanton AK se merr persiper sigurimin e kushteve te sigurise ne pune per te gjithe stafin e angazhuar per zbatimin e kesaj kontrate, duke ciluar AK nga cdo pergjegjesi ne rastin e aksidenteve ne pune.

2.3.4. Operatori ekonomik ofertues te paraqese nje deklarate nepermjet se ciles garanton se autosonda dhe pajisjet e tjera te kerkuara nuk jane te angazhuara ne nje kontrate tjeter dhe do te jene ne dispozicion te Autoritetit Kontraktor, ne cdo kohe gjate gjithë kohezgjatjes se kontrates.

2.3.5. Operatori ekonomik ofertues, për realizimin e kësaj kontrate duhet të disponojë fuqi punëtoresh prej **minimalisht 10 (dhjetë) persona**, duke përfshirë edhe drejtuesin teknik.

Për të vërtetuar këtë duhet të paraqitet:

- Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore për numrin e punonjësve të siguruar për tre muajt e fundit.

Shenim: Për përmbushjen e këtij kriteri operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës nr.9.

Ndërsa operatori ekonomik i renditur i pari duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër.

2.3.6. Për drejtuesin teknik të shoqërisë i cili duhet të jetë me profesion inxhinier naftë, të paraqitet:

- Diploma e shkollës së lartë.

-
- Çertifikata e Lejes Profesionale per aktivitetin e kerkimit, prodhimit e zhvillimit te lendeve hidrokarbure, te leshuar nga Ministria e Infrastruktures dhe Energjise.
 - Listepagesat e shoqërsë për tre muajt e fundit në të cilat inxhinieri i sipërcituar duhet të figurojë.

Shenim: Për përmbushjen e këtij kriteri operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojces nr.9.

Ndërsa operatori ekonomik i renditur i pari duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër.

2.3.7. Per te gjithë personelin teknik të deklaruar, i cili do te figuroje ne listepagesat e shoqerise operatori ekonomik te paraqese formularin e vetëdeklarimit sipas shtojces nr.9 ku te shenoje emrat e punonjesve duke specifikuar, pozicionin e punes per gjithesecilin.

2.3.8. Operatori ekonomik ofertues pjesë të stafit të ketë një specialist të certifikuar për përdorimin e sistemit BOP, i cili duhet të kryejë instruktimin dhe trajnimin e punonjësve të brigadës së autosondës për përdorimin e sistemeve BOP.

Për të vërtetuar këtë duhet të paraqiten:

- Certifikata përkatëse.
- Listepagesat e shoqerise per te pakten tre muajt e fundit ne te cilat specialisti i siperpermendur duhet te figuroje.

Shenim: Për përmbushjen e këtij kriteri operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojces nr.9.

Ndërsa operatori ekonomik i renditur i pari duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër.

